

**“PRONËSI ME DREJTËSI” NATIONAL ASSOCIATION**

**Defending Property, Pursuing Justice**

P.O. Box 258 • Tirana, ALBANIA

Phone: +355 33 22 4883 • E-mail: [property.justice@yahoo.com](mailto:property.justice@yahoo.com);

[pronesi\\_me\\_drejttesi@yahoo.com](mailto:pronesi_me_drejttesi@yahoo.com)

5 Shkurt 2011

**LETËR PUBLIKE**

**AMBASADORIT TË SHBA SHKËLQESISË TIJ z. ALEXANDER A. ARVIZU**

**AMBASADORIT TË BE SHKËLQESISË TIJ z. ETORE SEQUI**

**AMBASADORIT TË OSBE SHKËLQESISË TIJ z. EUGEN WOLLFARTH**

**Për dijëni**

**GJITHË TRUPIT DIPLOMATIK TË AKREDITUAR NË SHQIPËRI**

**Masmediave, institucioneve demokratike**

**Të nderuar zotëri ambasadorë !**

Unë shtetasi shqiptar Rrapo Hajredin Danushi, Kryetar i Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi”, shpreh falenderim për veprimtarinë tuaj në të mirë të popullit shqiptar.

Më lejoni të nënvizoj sa vijon: Shumë mirë që strukturat e BE dhe SHBA protestuan për vrasjen e tre qytetarëve në demonstratën e 21 janarit 2011, por çfarë duhet bërë kur më shumë se 3000 krime që janë shkaktuar pas 1991 për shkak të anarkisë së pronës dhe ankesat tona për pronën vazhdojnë të lihen në heshtje. Deklaratat për integrim të Shqipërisë në BE, nuk janë reale kur nga të gjitha qeveritë prej 1991 e deri sot nuk ka pasur dëshirë për të respektuar të drejtën e pronësisë.

Kryeministrit Sali Berisha e anuloi kundërprotestën që do të bënte Partia Demokratike në përgjigje të protestës së 21 Janarit 2011, por kjo nuk tregon se ai u tregua “burrë shteti”. Ai tregoi dinakërinë dhe demagogjinë që e karakterizon me të cilën u ka hedhur hi syve ambasadorëve. Sali Berisha, së bashku me ish kryeministrin Fatos Nano dhe klikat e tyre prej 20 vjetësh kanë miratuar ligje me të cilat ne të shpronësuarit nga diktatura vazhdojmë të mbetemi të shpronësuar, duke u ricikluar nëpër zyra dhe gjykata. Pronat tona të trashëguara nga brezat, që diktatura i shtetëzoi, pas vitit 1991 Shteti, në vend që t’ja kthejë të zotit, ato së bashku me pronat që ligjërisht i përkasin shtetit u përvetësuan dhe vazhdojnë të përvetësohen nga politikanët.

Këtu është thelbi i korrupsionit dhe i konfliktit të ashpër midis klaneve të politikës, që po shkatërron dhe shpërbën Shqipërinë dhe po vret popullin. Prandaj ai meriton plotësisht ta krahasosh me një presonazh të mirënjohur me emrin Ali Baba me 40 hajdutë.

Me keqardhje ankohe mi për ambasadorët e mëparshëm të SHBA z. William E. **Ryerson** dhe John **Withers** II, por dhe për ambasadorë të tjerë si ai i OSBE Osmo **Lipponen**, i B.E. Helmuth **Lohan**, ambasadorët e Bankës Botërore të FMN etj, që me qëndrimet e tyre

indiferente ndaj ankesave tona për shkeljen sistematike të të drejtës së pronës, kanë bërë që në Shqipëri korrupsioni për pronat të zhvillohet pa pengesa në nivel institucional.

Populli ynë ka një proverbë që thotë: Ujku qimen e ndryshon por vesin nuk e harron. Kështu ka ndodhur e po ndodh me sekretarin e partisë, së Enver Hoxhës, komunistin Sali Berisha. Ai ka qenë është dhe do të jetë deri në fund të jetës antipronar, pasi i tillë është formimi i tij. Ai nuk pyet për ligjin për institucionet dhe as për kushtetuten. Difekt tjetër i rëndë i tij është se ai e percepton realitetin dhe demokracinë ashtu siç e koncepton në mendjen e tij dhe kjo është krejt ndryshe nga perceptimi për njerëzit normalë. Ai e filloi jetën e tij me urrejtje të madhe për pronarët shqiptarë të shpronësuar nga diktatura dhe në këtë rugë të gabuar do ta mbylli problemin me pronën.

Ambasadori i parë i SHBA z. Ryerson, e propagandoi komunistin e devotshëm Sali Berisha, sikur ai të ishte demokrat, kur në fakt ai ishte një komunist që nën petkun e pluralizmit realizoi një sistem korruptiv dhe kleptokratik. Ambasadori Ryerson, nuk dëgjoi ankesat tona për pronat dhe kështu devijoi zhvillimin normal të proceseve demokratike. Heshnja dhe qëndrimet indiferente të ambasadorëve të tjerë ndaj ankesave dhe propozimeve tona konkrete për të korigjuar këto gabime kanë shkaktuar anarkinë aktuale që po e shpërbën Shqipërinë.

Zotëri Ambasadorë: Dëshirojmë të theksojmë se është e domosdoshme që institucionet dhe personalitetet e politikës ndërkombëtare të informohen saktë se pas vitit 1991 Shqipëria ka kaluar nga diktatura në kleptokraci dhe anarki institucionale, ka kultivuar korrupsionin në çdo instance. Nga kjo situatë pasurohen vetëm familjet e pushtetarëve dhe klanet e tyre. Këtë anarki postkomuniste, të realizuar nga Sali Berisha e Fatos Nano dhe të mbështetur moralisht dhe financiarisht nga perëndimi po e vuan shtresa e pronarëve origjinalë të shpronësuar nga diktatura komuniste; ku veç konflikteve atrificiale dhe vrasjeve që janë provokuar, pronarët po vazhdojnë të jetojnë keq ose dhe të vuajnë për bukën e gojës. Të tillë politikanë pa atdhetarizëm, abuzues, demagogë, grabitqarë dhe kaq dëmprurës për demokracinë dhe popullin e vendit tyre, nuk i duhen Bashkimit Europian dhe as SHBA.

Në kushtet aktuale, ku dominon korrupsioni dhe kleptokracia e vetmja mundësi për ta kurrar situatën dhe për ta futur Shqipërinë në rrugën e demokracisë, është kushtëzimi ndërkombëtar, duke vendosur si kusht paraprak, për shtetin detyrim për të kthyer me ligj pronën e grabitur tek i zoti, duke përcaktuar dhe afat kohor për këtë veprim. Nëse prona do vazhdojë të trajtohet si problem i brendshëm, qytetarët do vazhdojnë të vriten me njëri tjetrin për konflikte pronësie dhe kjo politikë do provokojë kriza të tjera akoma më të rënda.

Në përfundim ju lutemi që këtë letër t'ja transmetoni Sekretares së Departamentit Amerikan të Shtetit znj. Hillary Clinton, Institucioneve që përcaktojnë politikën e OSBE, BE dhe Këshillit të Europës ndaj Shtetit Shqiptar.

Me bindje se ju do ti informoni saktësisht këto instanca eprore , ju falenderoj paraprakisht.

Me respekt  
**Rrapo Hajredin Danushi**

Kryetar i Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi”